

AKTI I THEMELIMIT
DHE
STATUTI I SHOQËRISË
ITALB GROUP SHPK

THEMELIMI

Neni 1
Ortakët themelues

- 1.1 Shoqëria ITALB GROUP SHPK themelohet nga Ortakët si më poshtë vijojnë:
- Z. Federico Coppola, shtetas italian, lindur më 10.02.1963, ne Tolmezzo (UD), resident ne Via Garibaldi, 4, Budrio (BO) - Italia, mbajtes i Pasaportes me nr. YB1699666;
 - Znj. Nadia Cornigli, shtetase italiane, lindur më 01.05.1969, ne Faenza (RA), resident ne Brisighella, Via Risorgimento No. 4 – Italia, mbajtes i Kartes se Identitetit me nr. AT2418055.

EMËRTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

Neni 2
Emërtimi

- 2.1 Emërtimi i shoqërisë është ITALB GROUP.

Neni 3
Forma ligjore

- 3.1 Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar dhe është themeluar në përputhje me legjislacionin tregtar në Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar.



Neni 4
Baza ligjore

- 4.1 Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, me Aktin e Themelimit, legjislacionin tregtar dhe dispozita të tjera ligjore.

Neni 5
Kohëzgjatja e veprimtarisë

- 5.1 Veprimtaria e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit ("QKB").
- 5.2 Afati i veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

Neni 6
Selia

- 6.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Njesia Bashkiake Nr. 2, Rruga Themistokli Gërmenji, Pallati Pegaso, Kati 7, Ap. 30 – Tirane.
- 6.2 Administratori i shoqërisë mund të vendosë të hapë degë dhe/ose filiale dhe/ose adresa sekondare dhe/ose zyra përfaqësimi të shoqërisë si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë saj ose mund të crregjistrojë ato ekzistuese sipas ligjeve në fuqi.
- 6.3 Shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen në Shqipëri dhe/ose jashtë saj me vendim të Administratorit të shoqërisë.

Neni 7
Emblema. Vula

- 7.1 Shoqëria do të ketë emblemën dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga administratorët e shoqërisë.
- 7.2 Forma dhe përmasat e vulës do të përcaktohen në përputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar.



7.3 Të gjitha dokumentet e shoqërisë duhet të përmbajnë emblemën dhe vulën e saj.

Neni 8

Objekti

8.1 Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

- Projektimi, instalimi, tregtimi, marrja/dhenia me qira dhe menaxhimi i pajisjeve për lojra, lojëra automatike me monedha, struktura argëtimi fikse dhe të lëvizshme, parqe ujore, parqe zbavitëse dhe parqe tematike për fëmijët dhe të rriturit.
- Shitja, marrja/dhenia me qira, menaxhimi i atraksioneve sportive dhe terreneve sportive të destinuar për turizëm, qendra tregtare dhe vende të hapura për publikun në përgjithësi, si publike ashtu edhe private.
- Menaxhimi i hoteleve, restoranteve, bareve, pubs, lokaleve për aparaturat e lojërave të fatit, vende kampimi, klube nate dhe çdo aktivitet tjetër të destinuar për argëtim dhe zbavitje.
- Krijimi dhe menaxhimi i palestrave, qendrave të trajtimit, parukerive, ferma bukurie (beauty farm), Spa, klinikave private.
- Shitja dhe marrja/dhenia me qira, eksportimi i importit të anijeve, ndërtimi dhe menaxhimi i marinave, moleve, menaxhimi i anijeve për peshkim sportiv dhe ekskursione turistike.
- Tregtimi dhe import / eksporti i të gjitha llojeve të pajisjeve argëtuese.
- Tregtimi dhe import / eksporti i mobiljeve dhe elemente të mobilimit, si për brendshme dhe të jashtme.
- Tregtimi dhe import / eksporti i produkteve ushqimore dhe pijeve.
- Blerja, ndërtimi, dhënia me qira dhe menaxhimi i pasurive të paluajtshme për çdo përdorim të parashikuar.
- Krijimi i publikimeve, faqeve të internetit, blogjeve, materialeve promociionale dhe reklamuese, fushatave reklamuese për llogari vetjake dhe të palëve të treta, menaxhimit të TV dhe radios.
- Promovimi, organizimi dhe menaxhimi i panairëve, kongreseve, eventeve muzikore, sportive, rekreative, artistike dhe kulturore, garave sportive, aktiviteteve zbavitëse, turneve etj.



- Menaxhimi, blerja, shitja dhe marrja/dhenia me qira e pajisjeve dhe programeve kompjuterike të menaxhimit, automatizimit, industriale, te kontrollit dhe shërbim e asistence klienti nepermjet telefonit.
- Menaxhimin, blerjen dhe shitjen e instalimeve elektrike dhe paneleve elektrike, materialeve elektronike dhe elektromekanike për automatizimin, industriale dhe shtëpiake.

8.2 Objekti i shoqërisë mund të ndryshohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 9

Kapitali

9.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 130'000 ALL (njqind e tridhjetë mijë) Leke.

9.2.1 Kapitali ndahet në 2 (dy) pjesë.

9.3 Pronësia e kuotave ndahet midis ortakëve si vijon:

- Z. Federico Coppola, zotëron 75 % (shtatedhjetë e pese) të kapitalit e barabartë me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej 97'500 Lekë.
- Znj. Nadia Cornigli, zotëron 25 % (njetete e pese) % të kapitalit e barabarte me një pjesë, me një vlerë të përgjithshme prej 32'500 Lekë

9.4 Kapitali është shlyer tërësisht.


Neni 10

Transferimi i kuotave. Kufizimet.

10.1 Kuotat mund të transferohen tek të tretët në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" me amendimet perkatese.

10.2 Vendosja e çfarëdolloj barre mbi kuotat në favor të palëve të treta do të lejohet vetëm me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 11



Rritja e kapitalit

- 11.1 Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 11.2 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet gjithashtu edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të tjera të kapitalit nga ortakët e rinj. Ortakët e rinj pranohen dhe miratohen si të tillë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 12

Zvogëlimi i kapitalit

- 12.1 Zvogëlimi i kapitalit bëhet sipas procedurave të parashikuara nga legjislacioni tregtar.
- 12.2 Propozimi i zvogëlimit do t'i paraqitet ekspertit kontabël të autorizuar dhe administratorit të paktën 45 ditë përpara marrjes së vendimit nga Asambleja e Përgjithshme. Eksperti kontabël dhe administratori do të shqyrtojnë propozimin dhe do t'i paraqesin Asamblesë së Përgjithshme raportin në lidhje me arsyet dhe kushtet e zvogëlimit të kapitalit.
- 12.3 Raporti i zvogëlimit të kapitalit do të miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 13

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme

- 13.1 Vendimet kryesore mbi veprimtarinë e shoqërisë merren nga Asambleja e Përgjithshme.
- 13.2 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme përfshijnë kryesisht:
- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - Zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
 - Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë;



- Emërimin ose shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë si dhe percaktimin e shpërblimit për ta;
- Emërimin ose shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar si dhe percaktimin e shpërblimit për ta;
- Miratimin e bilancit të shoqërisë e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Transformimin e shoqërisë në forma të tjera;
- Cdo çështje tjetër të parashikuar në ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 “ Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” si dhe në këtë dokument.

Neni 14 Administrimi

- 14.1 Administrimi i shoqërisë kryhet nga një administrator ose një grup administratorësh që caktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.2 Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë dhe drejtojë punën e përditshme të shoqërisë në përputhje me udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 14.3 Administratori i shoqërisë është:
- **Z. Federico Coppola**, shtetas italian, lindur më 10.02.1963, në Tolmezzo (UD), resident në Via Garibaldi, 4, Budrio (BO) - Italia, mbajtes i Pasaportes me nr. YB1699666.
- 14.4 Administratori është përgjegjës për veprimtaritë e mëposhtme:
- Drejtimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë;
 - Të thërras Asamblenë e Përgjithshme;
 - Përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose me përfaqësim;
 - Hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
 - Përgatitjen e dokumentave në emër të shoqërisë sipas kompetencave që zoteron;

- Të zhvillojë veprimtari të tjera të çdo lloj natyre për të mirën e shoqërisë dhe realizimin e objektit të saj;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri tek palët e treta, insitucione apo entitete publike ose private;
- Të lidhë për dhe në emër të shoqërisë kontrata me palë të treta;
- Të punësojë dhe pushojë punëmarrës apo staf tjetër që konsiderohet i nevojshëm për mbarëvajtjen e biznesit në Shqipëri;
- Të vendos për ndryshimin e selisë së shoqërisë;
- Të përfaqësojë shoqërinë në Shqipëri përpara bankave të nivelit të dytë dhe Bankes së Shqipërisë si dhe të kryej, në emër të shoqërisë cdo transaksion bankar në emër të shoqërisë;
- Të ndërmarrë çdo veprimtari tjetër ose biznes ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshëm për biznesin e shoqërisë në Shqipëri.

14.5 Mandati i administratorit do të jetë i vlefshëm për 5 (pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje ose deri në çastin e revokimit të tij me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 15

Viti financiar

- 15.1 Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe mbaruar më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 15.2 Si përjashtim, viti i parë financiar i shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë në Zyrën e Tatim Taksave dhe përfundon më 31 Dhjetor të po atij viti.

Neni 16

Bilanci. Kontabiliteti.

- 16.1 Bilanci vjetor i shoqërisë shqyrtohet nga Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të përgatitet për t'u paraqitur para organeve tatimore deri në fund të muajit mars të vitit pasardhës.
- 16.2 Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe monedhën shqiptare si dhe sipas kërkesave të legjislacionit përkatës. Për operacione të veçanta, shoqëria mund të bëjë veprime edhe me llogari të veçanta në monedhë të huaj, duke bërë konvertimin brenda vitit.

- 16.3 Shoqëria mund të pranojë fonde nga institucionet financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë. Për këtë qëllim shoqëria mund të lërë peng pjesë të kapitalit si garanci ose mund të hipotekojë pasuritë e saj të paluajtshme, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 17

Te Ardhurat. Dividendi

- 17.1 Shoqëria do të krijojë fonde rezervë për realizimin e qëllimeve të biznesit të saj në përputhje me kërkesat e ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 17.2 Të ardhurat që do të rezultojnë në fund të mbylljes së cdo ushtrimori, pas pagimit të tatimeve, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport më pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë.
- 17.3 Humbjet e shoqërisë do të mbuloohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe ortakët do të pergjigjet deri në kufirin e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë. Humbjet transferohen nga mbyllja e ushtrimorit të parë deri në tre ushtrimorët vijues.

Neni 18

Likuidimi

- 18.1 Prishja e shoqërisë vendoset me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme.
- 18.2 Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme caktohet një likuidator ose një grup likuidatorësh që do të plotësojnë procedurat e likuidimit.
- 18.3 Likuidatori do të përgatisë raportin e likuidimit mbi gjëndjen ekonomike të shoqërisë, rreth operacioneve të mëtejshme të likuidimit dhe kohën që nevojitet për përfundimin e tij. Në përfundim të kësaj procedure, Asambleja e Përgjithshme do të shqyrtojë bilancin përfundimtar dhe do të miratojë përfundimin e procedurave të likuidimit.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

8



- 19.1 Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis shoqërisë dhe të tretëve, në rast se nuk zgjidhen me mirëkuptim do t'i nënshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 20
Klauzolë mbyllëse

20.1 Ky Statut hartohet në 4 (katër) kopje me fuqi të njëjtë ligjore.

Tiranë, datë 19.04.2018

ITALB GROUP SHPK
Ortakët e shoqërisë:

Z. Federico Coppola



Znj. Nadia Cornigli

